



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË NOTERËVE

Në zbatim të pikës 43 të Rregullores së Provimit të Kualifikimit, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 347, datë 15.10.2020, “Për miratimin e rregullorës së provimit të kualifikimit” në vijim të procesit të zhvillimit të provimit të kualifikimit për noterë, i zhvilluar në datë 03.09.2025, ora 11:00, në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 463, datë 17.07.2025, “Për caktimin e ditës, orës, vendit të zhvillimit të provimit të kualifikimit për noterë, afatit të paraqitjes së kërkesave për shprehje interesi për të hyrë në provim dhe dokumenteve përkatëse që duhet të shoqërojnë kërkesën”, si dhe pas miratimit të rezultatet përfundimtare të provimit me shkrim, Komisioni i Kualifikimit për Noterë,

VENDOSI:

Data e zhvillimit të provimit me gojë të jetë,

data 17.09.2025, ora 15:00

Shënim: Kandidatët me të paktën 60 pikë, hyjnë në provimin me gojë, në datën 17.09.2025.

Ky afishim është i barasvlefshëm me njoftimin e çdo kandidati, i cili ka të drejtën të vijojë me pjesëmarrjen në provimin me gojë, bazuar në pikën 43 të Rregullores së Provimit të Kualifikimit.

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT PËR NOTERË